



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik DPSH Starlin & N.N. Blendi Color të datës 20.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i Shkollës Gjin Gazulli" me nr. të prokurimit 616-22-12264-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 172 521, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik DPSH Starlin & N.N. Blendi Color e datës 20.02.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës të datës 15.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i Shkollës Gjin Gazulli" me nr. të prokurimit 616-22-12264-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 172 521.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i Shkollës Gjin Gazulli" me nr. të prokurimit 616-22-12264-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 172 521 sipas njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 15.02.2023 në përputhje me nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. pikën b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik DPSH Starlin & N.N. Blendi Color si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Operatori ekonomik DPSH Starlin & N.N. Blendi Color (tutje si "parashtruesi") me datë 20.02.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës të datës 15.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i Shkollës Gjin Gazulli" me nr. të prokurimit 616-22-12264-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 172 521. Pretendimet e parashtruesit janë lidhur me çmimet jo normalisht të ulta të paramasës dhe paralogarisë në pozicionet nr. 1.2.1., 2.1 deri 2.9, 2.12 dhe 2.13, 9.1 dhe 9.6. që janë ofertuar nga tenderuesi i suksesshëm operatori ekonomik N.T.P. Poni & Top Projekt Sh.P.K. duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 61 lidhur me nenin 1, 7, 59 dhe 60 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje si "LPP").

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 23.02.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimet e parashtruara në kërkesën për rishqyrtim janë të pabazuara në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nën paragrafi d) të LPP, për arsytet e elaboruara si në vijim.

Përmes nenit 41 paragrafit 1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje si "RRPP") përcaktohet se "Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës".

Tutje përmes nenit 41 paragrafit 3 të RRPP përcaktohet se "Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë".

Bazuar në Raportin e Komisionit për Vlerësimin e Tenderëve në këtë aktivitet të prokurimit është evidentuar se ekzistojnë tetë (8) operator ekonomik të përgjegjshëm.

Bazuar në nenin 27 paragrafin 1 të LPP, Komisioni për Vlerësim duke u bazuar në kriterin e tenderimit "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë" ka rekomanduar si tenderues të suksesshëm Grupin e Operatorëve Ekonomik N.T.P. Poni & Top Projekt Sh.P.K. me çmimin total të ofertës me TVSH prej 309,721.94 Euro. Tenderi i dytë më i ultë në këtë rast ka qenë i vet parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim respektivisht Grupit të Operatorëve Ekonomik D.P.Sh. Starlin & N.N. Blendi Color e çmimin total të ofertës me TVSH prej 336,023.43 Euro. Rrjedhimisht çmimi i ofruar nga operatori i suksesshëm ekonomik është 7.82% (përkatësisht më pak se 10%) më i ultë se çmimi i ofruar nga tenderi i përgjegjshëm i dytë më i ultë.

Tutje, çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm është 363,110.17 Euro. Kjo nënkupton se çmimi i ofruar nga tenderuesi i suksesshëm është 14.7% (përkatesisht më pak se 30%) më i ultë se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Me këtë rast Komisioni Vlerësues me kujdes profesional ka analizuar të gjitha çmimet e ofruara në tenderët e përgjegjshëm duke përfshirë këtu edhe çmimet e ofruara në paramasa dhe paralogari të cilat kontestohet nga parashtruesi, si dhe të njëjtat i kanë krahasuar me njëra tjetrën dhe me çmimet e tregut. Në këtë mënyrë sipas raportit të komisionit vlerësues është gjetur se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 41 paragrafin 3 lidhur me paragrafin 1 si dhe nenin 41 paragrafin 4 të RRPP. Prandaj nuk ekziston dyshimi i autoritetit kontraktues për tender jo-normalisht të ultë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duhet shtuar se parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi me të cilën do të mund të argumentoheshin pretendimet e paraqitura përmes kërkesës për rishqyrtim.

Bazuar në gjetjet dhe argumentet të elaboruara më sipër, autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka arritur te përfundimi se pretendimet e parashtruara në kërkesën për rishqyrtim janë të pabazuara në kuptim të nenit 62 paragrafit 1 nënparagrafit d) të RRPP.

Për pikën I të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. pikën b) të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Prishtinë, 23.02.2023**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit vendimit.